



Nr. 2167 prot.

Tiranë, më 13/12/2016

**Drejtuar: Agjencisë së Prokurimit Publik**

**Tiranë**

**Lënda:** Botim njoftimi në Buletinin e Njoftimeve Publike.

Rektorati i Universitetit të Arteve shpall konkursin për 2(dy) vënde të lira pune për punonjës mësimorë dhe punonjës administrate si më poshtë:

**Fakulteti i Artit Skenik:**

- **Specialist në Programin e Studimit Regji Filmi & Tv;**
- **Punonjës mësimorë nga kategoria Asistent Lektor në Pogramin e Studimit Regji, Regji Filmi & TV.**

**I.** Kandidati për pozicionin e lirë të punës së **Specialistit** duhet të plotësojë këto kritere:

- 1.1 Të ketë kryer arsimin e lartë (master i shkencave/master në arte) në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar nga MAS;
- 1.2 Të jetë me eksperiencë si teknik i specializuar në këtë program studimi (kamera, aparatë fotografikë, programe montazhi dhe softwa për film);
- 1.3 Të dëshmojë se ka njohuri të mjaftueshme ndaj elementëve teknikë dhe audio - vizivë;
- 1.4 Të ketë eksperiencë të mëparshme në përdorimin e ndriçimit, imazhit dhe audios në sheshin e xhirimit;



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

- 1.5 Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, raportuese dhe të dijë të komunikojë në grup, në zbatim të Kodit të Etikës;
- 1.6 Të ketë dëshmi të një nga gjuhët ndërkombëtare (preferohet anglisht);
- 1.7 Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere nga Gjykata;

**Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit, duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:**

- 1.1 Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkuron;
- 1.2 Diplomë origjinale + listë notash/ fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë, preferencë do të kenë kandidatët që kanë mbaruar në programin e studimit Regji Filmi & TV, (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit njehsimi nga MAS);
- 1.3 Jetëshkrimi (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- 1.4 Dokument (fotokopje e librezës së punës), që vërteton përvojën në punë;
- 1.5 Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- 1.6 Dy rekomandime nga profesorë apo regjisorë të njohur në fushën e filmit dhe televizionit;
- 1.7 Dëshmi e gjuhës së huaj;
- 1.8 Kopje e letër njoftimit ose kartës së identitetit;
- 1.9 Çertifikatë familjare;
- 1.10 Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- 1.11 Dëshmi e gjendjes mjeksore;

Vlerësimi gjithsej për dosjen do të jetë 100 pikë.



**II.** Kandidati për pozicionin e lirë të punës së **punonjësit mësimorë nga kategoria "Asistent Lektor"** duhet të plotësojë këto kritere:

- 2.1 Të ketë kryer arsimin e lartë (master i shkencave/master në arte) me rezultate të mira në Universitetin e Arteve. Në rastet kur studimet janë kryer në një shkollë të lartë në arte jashtë vendit, diploma duhet të jetë e njehsuar nga MAS;
- 2.2 Të ketë përvojë pune në televizion;
- 2.3 Të ketë eksperiencë pune si gazetar radio e televizioni me emisione apo cikle emisionesh;
- 2.4 Të ketë përvojë pune si pedagog në IAL jo më pak se 3 (tre) vite akademike;
- 2.5 Të ketë realizuar filma apo dokumentarë televizivë, jo më pak se 4 (katër) te tillë;
- 2.6 Të jetë i kualifikuar/trajnuar për film dhe televizion;
- 2.7 Të njohë programet bazë kompjuterike që i përshtaten pozicionit të punës si: Adobe Premierë (paketa e plote) dhe Final Cut (paketë e plotë);
- 2.8 Të ketë dëshmi të një nga gjuhët e huaja (Anglisht, Frengjisht, Gjermanisht, Italisht, Rusisht);
- 2.9 Të ketë 2 (dy) rekomandime nga profesionistë të fushës;
- 2.10 Të ketë aftësi të mira komunikuese, menaxhuese, raportuese dhe të dijë të komunikojë në grup, në zbatim të Kodit të Etikës;
- 2.11 Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prere nga Gjykata;

**Dokumentacioni që duhet të plotësojë çdo dosje e kandidatit, duhet të përmbajë materialet e mëposhtme:**



- 2.12 Kërkesë nga kandidati ku të jetë përcaktuar specialiteti për të cilin konkuron;
- 2.13 Diplomë origjinale + listë notash/ fotokopje e noterizuar që vërteton kryerjen e arsimit të lartë, (për kandidatët që kanë mbaruar jashtë vendit njehsimi nga MAS);
- 2.14 Jetëshkrimi (CV), i shoqëruar me dokumentacionin përkatës që vërteton elementët e paraqitur në të;
- 2.15 Vërtetimin që dëshmon përvojën e punës në televizion;
- 2.16 Vërtetimin që dëshmon përvojën e punës së gazetar radio e tv me emisione apo cikle emisionesh;
- 2.17 Dokument që vërteton realizimin e filmave dhe dokumentarëve televizivë;
- 2.18 Çertifikatë kualifikimi ose trajnimi për film dhe televizion;
- 2.19 Dëshmi/Çertifikatë kompjuteri;
- 2.20 Dokument (fotokopje e librezëz së punës), që vërteton përvojën në punë;
- 2.21 Letër reference/vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit;
- 2.22 Dy rekomandime nga profesionistë të fushës;
- 2.23 Dëshmi e gjuhës së huaj;
- 2.24 Kopje e letër njoftimit ose kartës së identitetit;
- 2.25 Çertifikatë familjare;
- 2.26 Dëshmi e gjendjes gjyqësore;
- 2.27 Dëshmi e gjendjes mjeksore;

Vlerësimi gjithsej për dosjen do të jetë 100 pikë.



Adresa: Blv. "Dëshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel/Fax: +355 42 225 488, www.uart.edu.al

Konkurrimi do të bazohet në plotësimin e kriterëve profesionale të rektoratit dhe njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht në Ligjin nr.80/2015 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL, në Republikën e Shqipërisë", Kodin e Proçedurave Administrative, Statutin e Univesitetit të Arteve, i ndryshuar.

Dosjet e kandidatëve do të dorëzohen në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerezore në UART, duke filluar nga data **19.12.2016** deri më datë **31.12.2016** ora **14.00**.

Për datën e konkursit kandidatët të informohen pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerezore UART, çdo ditë nga ora **08.00** deri në orën **14.00**.

Prof. Kastriot ÇAUSHI



REKTOR

UNIVERSITETI I ARTEVE